



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 24/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12/01/2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “VICTORIA INVEST” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Sistemime malore përrenj-St.Trenit dhe M.Alla, Ndërtim Prita Gjovac, Ndërtim Prita Polis-Gostime(vazhdimi), projekte për mbrojtjen bujqësore*”, me nr. REF-29748-10-13-2017, me fond limit 17,083,331 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “VICTORIA INVEST” sh.p.k.
Adresa: Lagjia 28 Nëntori, Rruga “11 Nëntori”, Elbasan.

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Librazhd.
Adresa: Sheshi “Gjorg Golemi”, Librazhd.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Rrethanat e çështjes



II.1. Në datën 16.10.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Sisteme malore përrenj-St.Trenit dhe M.Alla, Ndërtim Prita Gjovac, Ndërtim Prita Polis-Gostime(vazhdimi), projekte për mbrojtjen bujqësore”, me nr. REF-29748-10-13-2017, me fond limit 17,083,331 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd.

II.2. Në datën 07.11.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 24.11.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. ”Viante Konstruksion” sh.p.k.	15,119,670.00 lekë pa tvsh	Kualifikuar;
2. “Victoria Invest” sh.p.k.	15,299,807.46 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
3. “Hastoci” sh.p.k.	16,384,638.48 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
4. “Kupa” sh.p.k.	16,861,669.00 lekë pa tvsh	Skualifikuar;
5. “Restaurim Gura-Kaca” sh.p.k.	17,045,050.00 lekë pa tvsh	Kualifikuar;

II.4. Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

“Te skualifikoje operatorin ekonomik VICTORIA INVEST sh.p.k , per shkak se operatori ekonomik ka penalitete ndaj Bashkise Librazhd per shkak te tejkalimit te afatit te realizimit te punimeve ne nje kontrate te meparshme me AK Bashkia Librazhd, cka do te thote se nuk permbush piken 2.2 e) te kritereve per kualifikim shtojca 10 e DT e me tej do te thote se nuk gezon besueshmerine e percaktuar nga neni 46 pika 1 germa b te LPP . Konkretisht , ne kontraten nr.5400 prot date 28.09.2016 me objekt “Rikualifikim urban zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore”, rezulton me tejkalim te ndjeshem te afatit te percaktuar ne kontrate per realizimin e punimeve. Sipas nenit 5 te kontrates “Rikualifikim urban zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore.”afati I perfundimit te punimeve ka qene tre muaj duke filluar nga data 29.10.2016 , pra data 29.01.2017 kurse nga mbikqyresi I punimeve (organi qe ligji 8402/1998 Per kontrollin e disiplinimin e punimeve ne ndertim “ percakton per komunikimin mes kontraktorin e AK) ndersa njoftimi i perfundimit te punimeve prane Bashkise Librazhd eshte bere me shkresen nr.164,date 27.06.2017 . . Ne nenin 34 te kontrates se siperpermendur eshte percaktuar qarte se vonesat ne perfundim te afatit te punimeve do te perllogaritet penalitet sipas formules 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës. Konkretisht ne kete nen shkrehimisht thuhet ; Neni 34: Dëmet e Likuidueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve 34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifate mëposhtme ditore: Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates. Gjithe dokumentacioni I tejkalimit te afatit te realizimit te punimeve se bashku me njoftimin per penalitete per kete tejkalim i jane njoftuar shkreserisht kontraktorit debitor. K.V.O , eshte ne dijeni te faktit dhe disponon dokumentacionin e plote lidhur me kundershimet e pretendimet e kontraktorit per konstatimet e AK per tejkalimin e afatit te realizimit te punimeve ne kontraten “Rikualifikim urban zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore” KVO disponon edhe vendimin e Gjykates Administrative Durres nr.(82-2017-1365)934 ,date 30.10.2017, qe rrezon pretendimet e kontraktorit per detyrimin e AK per zgjatje te afatit te punimeve tej afatit te parashikuar ne kontrate sepse vonesat ne punime kane ardhur jo per shkak te tij por te A.K dhe motit . Ne kete vendim shprehimisht thuhet ;Ne daten 08.05.2017 kryetari I bashkise ngriti nje grup pune me urdherin nr.241,date 08.05.2017 per evidentimin e punimeve ne objektin” Rikualifikim urban zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore”,grupi I punes me relacionin e dates 10.05.2017 konstatoi se punimet nuk kishin perfunduar...Tashme jemi pas situates faktike qe mbikeqyresi I punimeve “MAK Studio”sh.p.k me shkresen nr.164,date 27.06.2017 ka njoftuar perfundimin e punimeve.Kjo do te thote se kerkese padia eshte pa objekt dhe nul pasi pala paditese e ka shkelur dhe afatin qe kerkon ne objektin e padise dhe asnjehere nuk ka pasur aftesine dhe besueshmerine per perfundimin ne afat te punimeve te marra persiper ne kontrate publike”Sa me lart gjykata konkludon rrezimin e padise.Gjykata ne vendimarrjen e saj ka parasysh nenet e kontrates te lidhur mes paleve kontraktuese,neni 35 I kontrates 5400,date 28.09.2016”Negociatat dhe amendamentet” Neni 35.2 I kushteve te pergjithshme te kontrates parashikon se ...”Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqesues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor. KVO veren se , operatori ka paraqitur ne sistemin elektronik nje vertetim

te leshuar nga Bashkia Librazhd date 06.11.2017, prot 6414 per mospasje detyrimesh per taksa e tarifa vendore. Ne kete vertetin shprehimisht thuhet se .. Citoj ...subjekti "Victoria Invest "sh.p.k ka shlyer detyrimet per taksa dhe tarifa vendore ndaj Bashkise Librazhd" Pra , ne dokumentin e leshuar nga bashkia Librazhd eshte specifikuar konkretisht per cfare lloj detyrimesh subjekti VICTORIA INVEST sh.p.k ka shlyer detyrimet.(detyrime per taksa dhe tarifa vendore). Pra eshte qartesisht e kuptueshme qe vertetimi I leshuar me nr.prot 6414,date 06.11.2017 per mospasje detyrimesh vendore perfshin vetem llojin e detyrimeve sipas nenit 9 te ligjit nr.9632,date 30.10.2006"Per Sistemin e Taksave Vendore" dhe jo detyrime te tjera sic eshte rasti i detyrimeve qe rrjedhin nga mos zbatimi te kushteve kontraktore. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" Në nenin 77 pika 2 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 , parashikohet se : "[...] 2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13 të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë. [...]" Ne kete rast , KVO në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës dhe nenit 70 te "Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit Ndërmjet Komuniteteve Europiane E Shteteve të tyre Anëtare Dhe Republikës së Shqipërisë", gjen me vend te zbatoje përcaktimet e nenit 57 "Arsyet e Përjashtimit" pika 4 gërma "g" të Direktivës 24/2014 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit "Për Prokurimin Publik" në të cilën parashikohet se "Autoritetet kontraktuese mund të përjashtojë nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi çdo operator ekonomik në ndonjë nga situatat e mëposhtme:.... g) ku operatori ekonomik ka treguar mangësi të mëdha apo të vazhdueshme në kryerjen e një kërkesë thelbësore në bazë të një kontrate të mëparshme publike, një kontratë paraprake me një subjekt kontraktues ose një kontrate koncesioni paraprak të cilat çuan në ndërprerjen e hershme të kësaj kontrate paraprake, dëmet ose sanksione të tjera të krahasueshme ; Pra , referuar bazez ligjore te siper cituar si dhe përcaktimeve te nenit 45/ 2/b dhe 77/2 te LPP, vendimti te Gjykates Administrative Dures nr.(82-2017-1365)934 ,date 30.10.2017 , pikes Te kriterëve per kualifikim shtojca 10 e DT , KVO ka kompetencen te skualifikoje nje operator ekonomik , kur vërtetohet se ky I fundit ka treguar mangësi në zbatimin e kontratave të mëparshme e per te cilat kontrata e meparshme parashikon penalitete konkrete . AK ,si perfituesi direct , I interesuari kryesor dhe qe ka pergjegjesi thelbesore ne realizimin me sukses te kontrates qe prokuron , nuk mund te riskoje e ligji I prokurimit e baza tjeter ligjore ne fuqi e aplikueshme per kete rast ia ofron kete mundesi duke shpallur fitues e besuar realizmin e punimeve perseri ketij operatori qe ka dhene prova se nuk respekton kushtet e kontrates . Persa me siper K.V.O ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik Victoria Invest sh.p.k."

II.5. Në datën 30.11.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]1. Ne lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik Viante Konstruksion sqarojme se ky operator ekonomik nuk permbush kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te DST per tu kualifikuar pasi nuk permbush piken 5 a dhe b te kritereteve te vecanta per kualifikim duke qene se nuk permbush numrin mesatar te punonjesve gjithashtu nuk permbush pikat 5.1, 5.2, 5.3 te kritereteve te vecanta per kualifikim duke qene se per drejtuesin teknik nuk disponon certifikaten e trajnimit për ”Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”, nuk disponon deshmi te aftesise profesionale te vlefshme per 3 drejtues te mjeteve te renda (1 eskavator me me zinxhire , nje eskavator me goma dhe nje automakinist) te cilet duhet te të figurojne ne listpagesa, nuk disponon pese punonjes te pajisur me kartelat personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente te akredituara ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr. 13/2013, date 14.02.2013 gjithashtu operatori Viante Konstruksion shpk nuk ka autorizim te vlefshem per perdorimin e lendeve plasese, per nevoja civile te leshuar nga autoriteti kompetent, inxhinieret e deklaruar dhe specialistet nuk jane të perfshire ne listepagesa dhe makinerite e deklaruar nuk jane ne perputhje me kerkesat e DST.

2. Ne lidhje me arsyet e skualifikimit te operatorit Victoria Invest shpk sqarojme KVO se:

2.1 KVO pretendon se operatori ekonomik Victoria Invest ka penalitete ndaj Bashkise Librazhd per shkak te tejkalimit te afatit te realizimit te punimeve ne nje kontrate te meparshme me AK Bashkia Librazhd, cka do te thote se nuk permbush piken 2.2 e) te kritereteve per kualifikim shtojca 10 e DT e me tej do te thote se nuk gezon besueshmerine e percaktuar nga neni 46 pika 1 germe. b te LPP . Konkretisht, ne kontraten nr5400 prot date 28.09.2016 me objekt “Rikualifikim urban ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore”, rezulton me tej kalim te ndjeshem te afatit te percaktuar ne kontrate per realizimin e punimeve. Sqarojme KVO se shoqeria jone gezon besueshmerine e plote per realizimin me sukses te kontrates se prokuruar pasi me date 11.09.2017 midis autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd dhe operatorit ekonomik Victoria Invest shpk eshte lidhur kontrate per pune publike Nr. 5435 Prot me objek “Rehabilitim Urban i zones ne te dyja anet e rruges kryesore, te qytetit te Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres”. Kjo kontrate eshte lidhur mbi bazen e procedures se prokurimit te zhvilluar po nga AK Bashkia Librazhd me date 24.04.2017 ku operatori ekonomik Victoria Invest shpk eshte skualifikuar nga AK Bashkia Librazhd per te njejtat arsye objekt i kesaj ankese[...]

[...]Keto pretendime jane rrezuar nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendim 568/2017 shfuqizon vendimin per skualifikimin e operatorit Victoria Invest shpk dhe kualifikimin e tij.

Sqarojme KVO prane AK Bashkia Librazhd se ceshtja lidhur me respektimin e kushteve te kontrates nr.5400 prot date 28.09.2016 me objekt “Rikuailfikim urban ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore” eshte nje ceshtje e izoluar dhe qe mund te zgjidhet vetem ne gjykate dhe me ceshtje themeli. Ju sjellim ne vemendje se qe nga data kur kane mbaruar punimet dhe deri me sot kane kaluar mbi 5 muaj dhe asnje verpim nuk eshte kryer nga ana e Bashkise Librazhd per kolaudimin e objektit duke na penguar ne likujdimin e situacionit perfundimtar.

Në lidhje me vendimin e Gjykates Administrative Durres nr.(82-2017-1365)934 ,date 30.10.2017 te permenduar nga ana juaj ju bejme me dije se arsyeja per te cilen ne i jemi drejtuar gjykates administrative ishte sepse AK Bashkia Librazhd ne menyre arbitrare refuzoi kerkesen tone per shtyrje te afateve te punimeve ne objektin “Rikualifikim urban ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore”. Objekti I kerkeses padise ishte : “shfuqizimin e aktit administrative

nr.2256/1 date 02.05.2017 te Bashkia Librazhd, duke pranuar kerkesen Nr 95. Prot date 10.04.2017 e "MAK. STUDIO" shpk drejtuar Bashkise Librazhd". Pra detyrimin e bashkise Librazhd te pranoje kerkesen per shtyrje te afateve. Ne vendimin e saj gjykata administrative dures shprehet se nuk mund te nderhyje ne nje ceshtje kontraktuale midis paleve pasi kontrata nuk eshte zgjidhur ende dhe ne vendimin e saj gjykata shprehet....Kerkimin e objektit e padise gjykata nuk e gjen te bazuar ne kuptim te dispozitave e vendosura ne bazen ligjore te padise...[...]"

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 679/1 Prot. datë 06.12.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Victoria Invest" sh.p.k., në datën 11.12.2017, duke mos pranuar asnjë prej pretendimeve të ngritura prej tij.

II.7. Në datën 15.12.2017 pala ankimuese "Victoria Invest" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke shtuar pretendime mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "Viante Konstruksion" sh.p.k., si më poshtë vijon:

"[...].1. Ne lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik Viante KonstmkSION sqarojrne KPP se ky operator nuk permbush piken 2.3 te DST Kapaciteti teknik:

1.Pune te ngjashme a)Punë të ngjashme për një objekt te vetem ne nje vlere prej 50% te vleres se perllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit pra ky operator nuk ka kontrate te ngjashme per kryerjen e punimeve ne pritat e lumenjve.[...]"

II.8. Në datën 26.12.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.7156/1prot., datë 21.12.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Victoria Invest" sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi: "[...]2.1 KVO pretendon se operatori ekonomik Victoria Invest ka penalitete ndaj Bashkise Librazhd per shkak te tejkalimit te afatit te realizimi te punimeve ne nje kontrate te meparshme me AK Bashkia Librazhd, cka do te thote se nuk permbush piken 2.2 e) te kriterave per kualifikim shtojca 10 e DT e me tej do te thote se nuk gezon besueshmerine e percaktuar nga neni 46 pika 1 germe. b te LPP . Konkretisht, ne kontraten nr5400 prot date 28.09.2016 me objekt "Rikualifikim urban ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore", rezulton me tej kalim te ndjeshem te afatit te percaktuar ne kontrate per realizimin e punimeve. Sqarojme KVO se shoqeria jone gezon besueshmerine e plote per realizimin me sukses te kontrates se prokuruar pasi me date 11.09.2017 midis autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd dhe operatorit ekonomik Victoria Invest shpk eshte lidhur kontrate per pune publike Nr. 5435 Prot me objek "Rehabilitim Urban i zones ne te dyja anet e rruges kryesore, te qytetit te Librazhdit dhe sistemim, asfaltim rruga e Dibres". Kjo kontrate eshte lidhur mbi bazen

e procedures se prokurimit te zhvilluar po nga AK Bashkia Librazhd me date 24.04.2017 ku operatori ekonomik Victoria Invest shpk eshte skualifikuar nga AK Bashkia Librazhd per te njejtat arsye objekt i kesaj ankese[...][...]Keto pretendime jane rrezuar nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendim 568/2017 shfuqizon vendimin per skualifikimin e operatorit Victoria Invest shpk dhe kualifikimin e tij.Sqarojme KVO prane AK Bashkia Librazhd se ceshtja lidhur me respektimin e kushteve te kontrates nr.5400 prot date 28.09.2016 me objekt "Rikuailfikim urban ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore" eshte nje ceshtje e izoluar dhe qe mund te zgjidhet vetem ne gjykate dhe me ceshtje themeli. Ju sjellim ne vemendje se qe nga data kur kane mbaruar punimet dhe deri me sot kane kaluar mbi 5 muaj dhe asnje verpim nuk eshte kryer nga ana e Bashkise Librazhd per kolaudimin e objektit duke na penguar ne likujdimin e situacionit perfundimtar.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në pikën 2.2.e të shtojcës 10, "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

" e) Vertetim per mos pasje detyrimesh vendore , detyrime tatimore apo penalitete te evidentuara nga auditimet e kryera ne Bashkine Librazhd nga institucionet e ndryshem ligjzbatuese . Vertetim leshuar nga bashkia Librazhd . (kete vertetim operatoret mund ta terheqin dorazi por edhe ne rruge elektronike me anen e nje kerkese ne adresen e emailit info@bashkialibrazhd.gov.al dhe vertetimi do ju dergohet ne te njejten menyre)"

III.1.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriteritet e mësipërme, BOE ankimues, ndër të tjera ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

1. Vërtetim nr.6414prot., datë 06.11.2017, lëshuar nga sektori i tatim-taksave të Bashkisë Librazhd, me anë të së cilës vërtetohet se shoqëria "Victoria Invest" sh.p.k. ka shlyer detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore në Bashkinë Librazhd.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Ndërsa në nenin 53 pika 4 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar parashikohet se: "Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj"

III.1.4. Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon se kriteri i përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi që subjekti nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Librazhd apo penalitete të evidentuara nga auditimet e kryera në Bashkinë Librazhd, nga institucionet e ndryshëm ligjzbatuese si dhe arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues "Victoria Invest" shpk se nuk ka respektuar kushtet e një kontrate të mëparshme nuk gjejnë asnjë mbështetje ligjore në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar.

III.1.5. Duke mbajtur në vëmendje nenin 45 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “Autoriteti kontraktor përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit çdo kandidat ose ofertues, kur ka të dhëna se janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për ndonjë nga veprat e mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;
- b) korrupsion;
- c) mashtrim;
- ç) pastrim parash.
- d) fallsifikim

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentet e përmendura në pikën 3 të këtij neni dhe, kur ka dyshime, mund t’u drejtohet organeve kompetente për të marrë ndonjë informacion të nevojshëm për integritetin dhe gjendjen personale të ofertuesve në fjalë. Kur kërkohet informacion për ofertuesin rezident në një shtet të huaj, atëherë autoriteti kontraktor mund të kërkojë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente.

2. Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:

- a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit
- b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
- c) është dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- ç)
- d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
- dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
- e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë seksion, ose nuk ka pranuar t’i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.
- ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Autoriteti kontraktor pranon si prova të mjaftueshme, që shmangin përjashtimin e kandidatëve apo ofertuesve për rastet e parashikuara në pikat e mësipërme, këto dokumente:

- a) vërtetim nga dosja gjyqësore, ose në rast se nuk sigurohet kjo, një dokument të njëvlershëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent, gjyqësor apo administrativ, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikat 1 e 2, shkronjat “a”, “b” e “c”;
- b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

III.1.6. Akoma më tej referuar parashkrimeve me shkrim të autoritetit kontraktor si edhe arsyes të skualifikimit të pasqyruar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka ngritur pretendime se operatori ekonomik ankimues do të ketë penalitete që rrjedhin nga kontrata ndërkohë në nenin 77 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se : “[...] 2. Mospërmbushja e detyrimeve të kontratës nga ana e kontraktorit përbën shkak për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike sipas përcaktimeve të pikës 3/ç të nenit 13

të LPP-së. Në këtë rast, autoriteti kontraktor ka detyrimin të dërgojë në APP kërkesën për përjashtimin e këtij kontraktori nga pjesëmarrja në prokurimet publike brenda 3 (tre) muajve nga zgjidhja e kontratës apo përfundimi i saj, përfshirë këtu edhe periudhën e garancisë. [...]”

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në tërësi Komisioni vëren se për pretendimet e mësipërme mbi ekzistencën e detyrimeve të pretenduara nga ana e autoritetit kontraktor, ky i fundit në respekt të parashikimeve ligjore të LPP dhe VKM 914/2014 në asnjë rast nuk ka ngritur pretendime, apo të marrë masa iniciative për përjashtimin e operatorit ekonomik dhe/ose të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik për shkeljen e detyrimeve kontraktuale nga ky i fundit. Sa më sipër Komisioni gjykon se në rast se autoriteti kontraktor do të kishte pretendime në lidhje me mospërbushjen e detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorit ekonomik ankimues (sikundër në rastin konkret për mosrespektim të afatit të realizimit të punimeve), ka patur në dispozicion disa momente procedurale për rregullimin e marrëdhënies juridike, sikundër është zgjidhja e mosmarrëveshjes referuar parashikimeve ligjore të Kodit Civil si edhe detyrimin për paraqitjen e informacionit të sipërcituar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik për nisjen e procedimit hetimor për rastin konkret.

Gjithashtu, KPP referuar kriterit të vecantë të kualifikimit, vëren se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se ky vërtetim duhet të merret në Bashkinë Librazhd. Por, autoriteti kontraktor duhet të ndërmerre hapa konkretë ligjor për vjeljen e detyrimeve kundrejt subjektit mbi të cilin pretendohet se ka nuk ka respektuar afatin e realizimit të punimeve, referuar kontratës së lidhur mes palëve. Në kushtet kur autoriteti kontraktor nuk ka pasqyruar se ka ndërmarrë ndonjë nga hapat e mësipërm duke nisur nga përfundimi i kontratës për të cilën ngrihen pretendime deri në momentin e vlerësimit të ofertave në procedurën e prokurimit objekt ankimi, KPP gjykon se në rastin konkret nuk mund të shërbejë si kusht për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik, eksperiencia e tij e mëparshme me autoritetin kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Victoria Invest” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi: *“Ne lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik Viante Konstruksion sqarojme se ky operator ekonomik nuk permbush kriteret e pergjithshme dhe te vecanta te DST per tu kualifikuar pasi nuk permbush piken 5 a dhe b te kriterëve te vecanta per kualifikim duke qene se nuk permbush numrin mesatar te punonjesve gjithashtu nuk permbush pikat 5.1, 5.2, 5.3 te kriterëve te vecanta per kualifikim duke qene se per drejtuesin teknik nuk disponon certifikaten e trajnimit për “Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune”, nuk disponon deshmi te aftesise profesionale te vlefshme per 3 drejtues te mjeteve te renda (1 eskavator me me zinxhire , nje eskavator me goma dhe nje automakinist) te cilet duhet te të figurojne ne listpagesa, nuk disponon pese punonjes te pajisur me kartelat personale te sigurimit teknik, te leshuara nga organe kompetente te akredituara ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr. 13/2013, date 14.02.2013 gjithashtu operatori Viante Konstruksion shpk nuk ka autorizim te vlefshem per perdorimin e lendeve plasese, per nevoja civile te leshuar nga autoriteti kompetent, inxhinieret e deklaruar dhe specialistet nuk jane të perfshire ne listpagesa dhe makinerite e deklaruar nuk jane ne perputhje me kerkesat e DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Referuar VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 17, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:

- Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”

III.2.2. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.3. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe jo të shpreh vetëm mosplotësimin e tyre në mënyrë të pargumentuar. Theksojmë se, mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikisht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatorit pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

III.2.5. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga

KPP. Komisioni i Prokurimit Publik është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë dhe refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

III.2.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Victoria Invest” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt ankimi: *“Ne lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik Viante Konstruksion sqarojme KPP se ky operator nuk permbush piken 2.3 te DST Kapaciteti teknik:*

1.Pune te ngjashme a)Punë të ngjashme për një objekt te vetem ne nje vlere prej 50% te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit pra ky operator nuk ka kontrate te ngjashme per kryerjen e punimeve ne pritat e lumenjve.”, konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Victoria Invest” sh.p.k. në ankimin e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, nuk e ka ankimuar pretendimin e sipërcituar, por ka ngritur vetëm pretendimet e cituara në pikën III.1 të këtij vendimi, e rrjedhimisht ankimi i paraqitur prej tij nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi për faj të vetë ankimuesit, ankimi në KPP nuk është realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

Për rrjedhojë, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në konsideratë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Sisteme malore përrenj-St.Trenit dhe M.Alla, Ndërtim Prita Gjovac, Ndërtim Prita Polis-Gostime(vazhdimi), projekte për mbrojtjen bujqësore*”, me nr. REF-29748-10-13-2017, me fond limit 17,083,331 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.11.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Librazhd, lidhur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. për procedurën e prokurimit sipërcituar, lidhur me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Viante Konstruksion” sh.p.k.
3. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Victoria Invest” sh.p.k.

6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1840 protokoli Datë 15.12.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

